



POLITIKAT LOKALE në mbrojtjene mjedisit

Përvojat nga komunat e Regjionit të Prizrenit

Personeli:

Ismet KRYEZIU - Drejtor ekzekutiv
Vjollca VOGËL - Menaxhere e administratës dhe financave
Leonora CIKAJ - Asistente për administratë dhe financa
Donjeta DRESHAJ - Asistente për administratë dhe financa
Arsim GJINOVCI - IT & design

Programi *Qeverisja Lokale dhe Pjesëmarrja Qytetare*

Naim CAHANAJ - Koordinator
Kreshnik BASHA - Koordinator

Programi *Demokratizimi dhe Praktikrat Parlamentare*

Driton SELMANAJ - Menaxher i programit
Isuf ZEJNA - Asistent i projektit
Fitim SALIHU - Vëzhgues i parlamentit
Shkelzen LUSHAKU - Vëzhgues i parlamentit
Ganimete HESETI - Vëzhguese e parlamentit

Programi *Transparenca dhe Kundër-korrupsioni*

Merita MUSTAFA - Menaxhere e programit
Enis XHEMAJLI- Kryesues i hulumtimit
Besnik RAMADANAJ - Asistent i projektit
Natyra KASUMAJ- Koordinatore

Programi *Zgjedhjet e lira dhe të drejta*

Liridon SELMANI - Menaxher i programit

Përmbajtja

4

Hyre	5
Historiku dhe konteksti institucional	6
Qeveria qendrore në mbrojtjen e mjedisit	6
Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit i Kosovës	6
Infrastruktura ligjore në mbrojtjen e Mjedisit	9
Detyrimet e ndotësit të mjedisit	9
Kompetencat e komunave në mbrojtje të mjedisit lokal dhe gjendja në terren	10
Mbikqyrja Inspektuese	10
Infrastruktura ligjore në mbrojtjen e ujërave në Kosovë	12
Kompetencat e komunave në administrimin e ujërave	14
Kompetencat ligjore të komunave mbi administrimin e mbeturinave dhe problematika në teren	15
Legjislacioni për mbrojtjen e tokës bujqësore dhe ndikimi në mjedis	18
Kundërvajtjet	19
Konkluzione	20
Rekomandimet:	21
Lista e burimeve të shfrytëzuara	22

HYRJE

Mbrojtja e mjedisit dhe planifikimi hapësinor, duke përfshirë ajrin, ujin, tokën, etj., ka ndikim direkt në zhvillimin ekonomik e social si dhe mbrojtjen dhe përmirësimin e shëndetit publik.

Kosova gjatë gjithë kohës së pas-konfliktit ka aspiruar të anëtarësohet në Bashkimin Evropian. Ndër problemet e shumta që ka trashëguar Kosova dhe domosdo duhet të përmbushen dhe cilësohen si kritere shumë të rëndësishme për anëtarësim në strukturat e Bashkimit Evropian janë edhe problemet e mjedisit në përgjithësi.

Gjatë dekadës së fundit, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka treguar angazhim në miratimin e ligjeve sa i përket mbrojtjes së mjedisit në përgjithësi. Problemet e shfaqura në mos implementimin e ligjeve nga ana e Qeverisë, kanë qenë dhe janë ndër shqetësimet e Shoqërisë Civile në Kosovë. Nisma të tilla për senzibilizimin e përgjithshëm në mos implementimin e ligjeve që mbrojnë mjedisin; kanë ardhur kryesisht nga organizatat e Shoqërisë Civile.

Mos përcaktimi i kompetencave në nivelin horizontal dhe vertikal ka bërë që të prolongohet çështja e mbrojtjes së mjedisit e më të edhe shkatërrimi në masë të madhe resurset natyrore që ka Kosova.

Implementimi i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale i cili ka filluar të zbatohet që nga viti 2008, ka vërë themelet e qeverisjes lokale të bazuar në Kartën Evropiane për qeverisje lokale, ligj ky i cili shumë herë ka qenë në kritika të shumta për mos përcaktimin e qartë të kompetencave. Po ky ligj; kuvendeve komunale i lë në kompetencë edhe mbrojtjen e mjedisit lokal mirëpo që nga pas lufta asnjë nga qeveritë lokale nuk kanë arritur të jenë në nivel të mbrojtjes së mjedisit dhe në veçanti shtratin e lumit “Drini i Bardhë”.

Duke parë si shumë të rëndësishëm çështjen e mbrojtjes së mjedisit, në këtë dokument do të pasqyrohet baza ligjore që ka Kosova në mbrojtjen e mjedisit dhe gjendja aktuale që mbizotëron në komunitet e Regjionit të Prizrenit në mbrojtjen e mjedisit e në veçanti degradimi i shtratit të lumit Drini i Bardhë dhe shqetësimet nga vetë popullata në lidhje me këtë problematik që ndërlikohet edhe kualitetin e jetës së tyre.

HISTORIKU DHE KONTEKSTI INSTITUCIONAL

6

Qeveria qendrore në mbrojtjen e mjedisit

Qeveria e Kosovës ushtron pushtetin ekzekutiv në pajtim me Kushtetutën dhe ligj, zbaton ligjet dhe aktet e tjera të miratuara nga Kuvendi i Kosovës dhe ushtron veprimtari tjera brenda përgjegjësive të përcaktuara, merr vendime në pajtim me këtë Kushtetutë dhe me ligje, propozon projektligje dhe amendamentimin e ligjeve ekzistuese e akteve të tjera¹.

Në kuadër të dikastereve të Qeverisë së Kosovës bënë pjesë edhe Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinorë. Në kuadër të rregulloreve; përgjegjësitë e kësaj Ministrie kanë të bëjnë me krijimin dhe zbatimin e legjislacionit për menaxhimin e përgjithshëm në fushën e Mjedisit, Ujërave, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit e Banimit .

Në mënyrë që të bëhet një gjë e tillë, Ministria ka ngritur departamente, institute si dhe Agjencionin për Mbrojtjen e Mjedisit . Si e tillë kjo Ministri ka 7 departamente (Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit (DMM) , Departamenti i Planifikimit Hapësinor (DPH), Departamenti i Banimit dhe Ndërtimit (DBN) , Departamenti i Ujërave (DU), Departamenti i Administratës Qendrore (DAQ), Departamenti i Prokurimit (DP) , Drejtoria e Parkut Nacional “ Malet e Sharrit”, 2 Institute: Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës, Instituti për Planifikim Hapësinor, ka Inspektoratin si dhe Agjencionin Kosovar për Mbrojtjen e Mjedisit.

Agjencioni Kosovar për mbrojtjen e mjedisit në vete ngërthen tri drejtori: Drejtorinë e Sistemit Informativ Mjedisor, Drejtorinë e Monitorimit të Mjedisit dhe Drejtorinë e Hartimit të Raporteve, Planeve dhe programeve Mjedisore.

AGJENCIONI PËR MBROJTJEN E MJEDISIT I KOSOVËS

Me qëllim të monitorimit të cilësisë dhe vetive të mjedisit , Ministria ka themeluar Agjencionin për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK).

Detyrat e Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit në Kosovë janë : të siguroj informacionin e duhur për administratën, Qeverinë dhe Kuvendin e Kosovës për zbatimin e politikave për mbrojtjen e mjedisit; të zhvilloj dhe koordinoj sistemin unik të informimit për mbrojtjen e mjedisit lidhur me sistemin e përcjelljes së gjendjes së mjedisit në Kosovë si dhe të mbledhë të dhënat për mjedisin; ti vendosë dhe ti mbajë qendrat referente me bazat e të dhënave për përcjelljen e mjedisit (të dhënat socio-ekonomike, presionet në mjedis, gjendjen dhe kualitetin e mjedisit); të zhvillojë procedurat për përpunimin e të dhënave të grumbulluara për mjedisin dhe vlerësimin e tyre (modelimin, prezantimin dhe paraqitjen vizuale); të kryej punët profesionale gjatë përcaktimit të përmbajtjes, metodologjisë dhe mënyrës së përcjelljes të gjendjes së mjedisit; të avancojë dhe krahasojë cilësinë e të dhënave për mjedisin; të hartojë raporte për gjendjen e përgjithshme të mjedisit në Kosovë, synimeve, si dhe të raportojë për sektorët kryesor (ajrin, tokën, ujin,

¹ Neni 92 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, http://assembly-kosova.org/common/docs/Kushtetuta_sh.pdf

llojlojshmërinë biologjike, ndryshimet klimatologjike); të hartojë raporte për çështjet e caktuar për mbrojtjen e mjedisit siç janë rajonet me radioaktivitet të shtuar, cilësia e mjedisit, shëndeti dhe ngjashëm; kryen punë këshillëdhënëse për përcaktimin, mbajtjen dhe përcjelljen e projekteve dhe programeve për mbrojtjen e mjedisit; të ndihmojë organet e administratës në zhvillimin e formave të reja të politikës për mbrojtjen e mjedisit dhe përcjelljen e zbatimit të planeve dhe programeve për mbrojtjen e mjedisit; të bashkëpunojë me Agjencinë Evropiane të Mjedisit - AEM e cila është në përbërje të Rrjetit Evropian për Informim dhe Vëzhgim - RREIV; të bashkëpunojë me institucionet dhe organizmat tjerë ndërkombëtar për mbrojtjen e mjedisit ; të sigurojë qasjen në të gjitha informacionet për mjedisin e Kosovës sipas standardeve të AEM.; shfrytëzimi dhe këmbimi ndërshtetëror i të dhënave për mjedis do të rregullohet me ligj të veçantë.²

Situata e vështirë e trashëguar në fushën e planifikimit hapësinor dhe urban, mjedisit, menaxhimit dhe mbrojtjes së resurseve ujore, menaxhimit të mbeturinave, ndotjes së ajrit, ndotjes së tokës dhe humbjes së llojlojshmërisë biologjike, me shfrytëzimin e pakontrolluar të resurseve natyrore, zhvillimin e pakontrolluar të kapaciteteve industriale dhe afariste, në masë të ndjeshme ka filluar të përmirësohet. Në ndryshimin e ngadalshëm të kësaj gjendjeje ndikon edhe zbatimi i pamjaftueshëm i ligjeve ekzistuese dhe mungesa e akteve të tjera nënligjore. Qeveria ka përgatitur një kornizë ligjore, ndërsa në nivelin e implementimit, do të inkorporojë dhe zbatojë normat ndërkombëtare për adresimin e këtyre problemeve mjedisore.³

Ndër problemet në fushën e mbrojtjes së mjedisit në nivel lokal janë edhe eksploatimi i zhavorrit dhe gurorëve nga operatorët që mund të thuhet se kryesisht operojnë ilegalisht.

Në bazë të ligjit për miniera dhe minerale; autoriteti kompetent në dhënien e lejeve për shfrytëzim të minierave dhe mineraleve është Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM).

Asnjë person nuk mund të ushtrojë aktivitete të hulumtimit, shfrytëzimit dhe/ose përpunimit të resurseve minerale ose çfarëdo aktiviteti tjetër pa licencë ose leje të lëshuar nga KPMM në përputhje me këtë ligj.⁴

Bartësi i Licencës ose Lejes për Shfrytëzim nuk do të ushtrojë asnjë veprimtari në ndonjë sipërfaqe që: ndodhet më afër se dyqind (200) metra nga kufiri i një fshati,



Foto1. Eksploatimi i pakontrolluar i zhavorrit

qyteze, qyteti apo vendbanimi tjetër; ndodhet brenda një zone prej njëqind (100) metra prej ndonjë shtëpie ose ndërtese të banuar ose përkohësisht të pabanuar; ndodhet brenda dyzetepesë (45) metrave prej ndonjë toke që është pastruar ose lëvruar, ose në mënyrë tjetër të përgatitur për mbjelljen e farërave bujqësore ose mbi të cilën janë duke u rritur të mbjella bujqësore, përveç kur Bartësi i Licencës ose Lejes

² Neni 59 i Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit,

³ PVPE 2010, http://www.mei-ks.net/repository/docs/PVPE_2010_Final_-_SQ.pdf

⁴ Neni 4 Ligjit për Miniera dhe Minerale, <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2010-163-alb.pdf>

ka fituar të drejtat sipërfaqësore mbi këtë tokë; është shfrytëzuar gjatë dymbëdhjetë (12) muajve të kaluar për rritjen ose korrjen e të mbjellave bujqësore, përveç kur Bartësi i Licencës ose Lejes ka fituar të drejtat sipërfaqësore mbi këtë tokë; është brenda dyqind (200) metra prej ndonjë pende ose rezervuari etj.⁵

Nëse një inspektor i autorizuar ka arsye të mira për të besuar se një person është duke ushtruar aktivitete të hulumtimit, shfrytëzimit ose aktivitete të veçanta dhe se ky person nuk posedon Licencë ose Leje nga KPMM, inspektori menjëherë e informon Policinë e Kosovës e cila menjëherë dërgon së paku dy zyrtar policor në vendin e ngjarjes.

Nëse asnjëri nga këta persona ose punëdhënësi i tyre (nëse kanë punëdhënë) nuk posedojnë Licencë ose Leje nga KPMM, zyrtarët e policisë i arrestojnë Personat në fjalë të cilëve më pas u shqiptohet gjoja administrative e përcaktuar në paragrafin në bazë të këtij ligji dhe dënimet penale sipas të këtij ligji. Përveç kësaj, inspektori konfiskon të gjitha mjetet punuese dhe mineralet e nxjerra që gjenden në vendin e rastit.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë, në vitin 2005 kishte nxjerrë një VENDIM më qëllim të ndalimit të shfrytëzimit të gurëve, rërës dhe zhavorrit nga shtretërit dhe brigjet e lumenjve dhe atë nga brezi në gjerësi deri në 50 metra nga vija e bregut në të dyja anët e lumit, në të gjithë lumenjtë e Kosovës.



Foto 2. Seperacioni në mes të vendbanimit - Prizren

Përveç ndalimit të shfrytëzimit të rërës dhe zhavorrit në shtretërit e dhe brigjet e lumenjve me këtë vendim ishte ndaluar edhe vendosja e impianteve, konstruksioneve inxhinierike dhe mjeteve të punës, të cilat shërbejnë për veprimtarinë nga paragrafi 1 i këtij vendimi dhe larja e inerteve ose materialeve të tjera në shtretër ose brigje të lumenjve, si dhe shkarkimi i ujërave të cilat lirohen nga larjet e inerteve; pa pastrimin paraprak të tyre.⁶

Zyrtarë të qeverisë lokale nga Komuna e Prizrenit kanë pohuar se rreth mbrojtjes së shtratit të Drinit të Bardhë, Kryetari i Komunës ka marrë një vendim për themelimin e një Komisioni për caktimin e zonave për shfrytëzimin e inerteve mirëpo ky Komision nuk ka caktuar zonë për eksploatimin e zhavorrit dhe deri më tani Komuna nuk i ka dhënë pëlqim askujt.⁷

Në shumicën e rasteve organet komunale po edhe ato qendrore nuk janë në gjendje të përballen më shfrytëzuesit e eksploatimit të zhavorrit dhe gurorëve. Përveç degradimit të mjedisit lokal duke shkatërruar florën; faunën, tokën bujqësore këta operatorë aktivitetin e tyre e ushtrojnë edhe afër vendbanimeve duke ju cenuar dhe rrezikuar në masë të madhe edhe jeta e qytetarëve për rreth dhe në përgjithësi.

⁵ Po aty neni 13, <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2010-163-alb.pdf>

⁶ Vendim nr 55/2005 I Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë

⁷ Intervistë me z.Ramadan Tafallari- Zyrtar për mbrojtjen e mjedisit-Prizren

INFRASTRUKTURA LIGJORE NË MBROJTJEN E MJEDISIT

Asnjë institucion nuk mund ta lëshojë lejen për shfrytëzimin e resurseve natyrore pa pëlqimin mjedisor për projektin i cili duhet të përmban masat e mbrojtjes dhe rehabilitimit mjedisor.

Personi juridik dhe fizik i cili i shfrytëzon resurset natyrore, është i detyruar që gjatë kryerjes së punëve dhe zhvillimit të aktiviteteve, si dhe pas përfundimit të këtyre aktiviteteve, të planifikojë dhe të zbatojë masat me të cilat duhet të parandaloj ndotjen e mjedisit. Secili që dëmton mjedisin, është i detyruar të bëjë sanimin e mjedisit të dëmtuar, në përputhje me këtë ligj dhe ligjet tjera.

Kushdo që duke e shkelur ligjin bën ndotjen ose degradimin e mjedisit apo shfrytëzon jashtë mase burimet natyrore dhe me këtë shkakton rrezik për mjedisin dhe jetën e shëndetin e një numri të madh të njerëzve dënohet me burgim deri në dy vjet.⁸

Siç shihet edhe roli i organeve të drejtësisë në drejtim të mbrojtjes së mjedisit është i pashmangshëm. Edhe me kodin penal të Republikës së Kosovës parashihen ndëshkimet mbi personat fizik dhe juridik që shkaktojnë ndotjen e mjedisit. Policia dhe Prokuroria duhet të jenë më efektive sa i përket iniciativave për mbrojtjen e mjedisit në përgjithësi.

Personi juridik dhe fizik i cili i shfrytëzon resurset natyrore, është i detyruar që rregullisht të informojë Ministrinë rreth aktiviteteve të kryera. Raportet e tilla janë të hapura për publikun.⁹

Mbrojtja dhe ruajtja e përbërësve të mjedisit: tokës, ujit, ajrit, pyjeve dhe llojllojshmërisë biologjike dhe peizazhore, bëhet veç e veç dhe të lidhura ngushtë mes veti në ndërveprimin dhe integritetin e tyre, ndërsa rregullohen me ligje të veçanta.¹⁰

DETYRIMET E NDOTËSIT TË MJEDISIT

Personi i cili me veprimin ose mosveprimin e vet shkakton ndotjen e mjedisit, është i detyruar që të ndërmer masat e parapara me planin e mbrojtjes nga aksidenti mjedisor, planin për sanim dhe planin për rehabilitim. Nëse dëmi i shkaktuar në mjedis nuk mund të sanohet përmes masave adekuate, personi juridik ose fizik i cili ka shkaktuar dëmin duhet ta kompensoj dëmin në vlerën e të mirave të shkatërruara.

⁸ Neni 276 i Kodit Penal të Kosovës, http://www.md-ks.org/repository/docs/Kodi_i_Perkohshem_Penal_i_Kosoves_RA_2003-25.pdf

⁹ Neni 11i Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit, http://assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2009_03-L-025_al.pdf

¹⁰ Po aty neni 15

¹¹ Po aty neni 68

KOMPETENCAT E KOMUNAVE NË MBROJTJE TË MJEDISIT LOKAL DHE GJENDJA NË TERREN

Komunat janë të detyruara të organizojnë grumbullimin e mbeturinave komunale të cilat nuk mund të hidhen në kontejner (mbeturinat e vëllimshme). Komunat rregullojnë organizimin dhe mënyrën e veçimit të mbeturinave për riciklim, në përputhje me planin lokal.

Komunat miratojnë planet e veprimit lokal në mjedis ose programe mjedisore për mbrojtjen e mjedisit, në përputhje me Planin e Kosovës për Veprim në Mjedis sipas interesave specifike të saj . Në hartimin e planeve të veprimit lokal dhe programeve mjedisore, marrin pjesë. publiku, OJQ-të, organizatat profesionale dhe komuniteti i biznesit. Komunat i raportojnë Ministrisë për zbatimin e planit të veprimit lokal dhe programit mjedisor. Dy ose më shumë komuna mund të hartojnë dhe miratojnë së bashku plane ose programe të përbashkëta të veprimit për mbrojtjen e mjedisit për zvogëlimin e efekteve negative në mjedis¹². Qeveria, respektivisht komunat në kuadër të drejtave dhe detyrimeve të tyre, sigurojnë financimin dhe realizimin e politikave për mbrojtjen e mjedisit.¹³

Në raste të jashtëzakonshme, komuna e cila e ka statusin e zonës së rrezikuar mjedisore.

përcakton kompensimin për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit për çdo person juridik ose fizik që me veprimtarinë ose me aktivitetin e vetë ndotë ose mund të ndotë mjedisin.

Qeveria me vendim e miraton ose refuzon kërkesën e komunës për caktimin e lartësisë për kompensimin, mënyrën e pagesës, si dhe lehtësimet për çdo person juridik ose fizik që me veprimtarinë ose me aktivitetin e vetë ndotë ose mund të ndotë mjedisin¹⁴

MBIKËQYRJA INSPEKTUESE

Mbikëqyrjen inspektuese për zbatimin e këtij ligji si dhe akteve nënligjore të nxjerra prej tij, kushtet dhe metodën e punës së personave të mbikëqyrur si dhe masat për mbrojtjen e mjedisit të përcaktuara me këtë ligj e bënë Inspektorati mjedisor i Ministrisë.

Mbikëqyrjen inspektuese për Lejen Mjedisore Komunale e kryen inspektori komunal i mjedisit. Ministria mundet me autorizim të veçantë, të autorizoj inspektorin komunal të mjedisit për kryerjen e detyrave tjera. Punët e inspektorit mund t'i kryej edhe zyrtari tjetër për mbrojtjen e mjedisit të cilin e autorizon Ministria, gjegjësisht komuna.¹⁵

Me gjobë në të holla prej dhjetëmijë (10.000) deri në pesëdhjetëmijë (50.000) Euro gjo-

¹² Po aty neni 24

¹³ Po aty neni 73

¹⁴ Po aty neni 76

¹⁵ Po aty neni 81

bitet për kundërvajtje personi juridik nëse: shfrytëzon resurset natyrore pa pëlqimin mjedisor të Ministrisë; gjatë shfrytëzimit të resurseve natyrore, kryerjes së punëve, si dhe pas përfundimit të tyre nuk i zbaton masat e parapara për parandalimin e rrezikimit të mjedisit.



Foto 3. Deponi e egër ne komunën e Rahovecit

Me gjobë në të holla prej dhjetëmijë (10.000) deri në pesëdhjetëmijë (50.000) Euro gjobitet për kundërvajtje personi juridik nëse: shfrytëzon resurset natyrore pa pëlqimin mjedisor të Ministrisë; gjatë shfrytëzimit të resurseve natyrore, kryerjes së punëve, si dhe pas përfundimit të tyre nuk i zbaton masat e parapara për parandalimin e rrezikimit të mjedisit¹⁶.

Deri më tani asnjë nga Komunat e Regjionit të Prizrenit nuk ka miratuar Planin e Veprimit Lokal në Mjedis, ku në bazë të ligjit për mbrojtjen e mjedisit Komunat obligohen të kenë Planin e Veprimit Lokal në Mjedis. Përveç komunës së Prizrenit e cila ka filluar të hartojë planin e tillë komunat tjera ende nuk kanë ndërmarrë një hap të tillë edhe pse nga zyrtarët e qeverisë lokale konsiderohet si i vonuar.

Duke e konsideruar tejet të rëndësishëm mbrojtjen e mjedisit, disa nga Kuvendet e komunave kanë ndërmarrë edhe hapat e nevojshëm për hartimin e legjislacionit komunal për rregullimin e bazës ligjore për mbrojtje të mjedisit duke miratuar edhe Rregulloret për mbrojtjen e Mjedisit.¹⁷

Mirëpo, mungesa e kapaciteteve të inspektoratit mjedisor në komuna¹⁸ ka bërë që të mos zbatohen rregulloret në fjalë. Për më tepër nga intervistat me zyrtarë është pohuar se dispozitat ndëshkuese kanë hasur në vështirësi në drejtim të zbatimit ngase është e pamundur të shqiptohen gjobat mandatore dhe për pasojë duhet të ndërrohet qasja e tillë e ndëshkimeve dhe të shkohet më procedurë gjyqësore.¹⁹

Po ashtu inspektoratet e nivelit qendror janë treguar jo të efektshëm në inspektimet e tyre. Pos tjerash; edhe përkundër ekzistimit të inspektorëve komunal të cilët kanë një bashkëpunim të mirë ndërmjet veti me inspektorët e nivelit qendror; rezultatet konkrete po mungojnë dhe si pasojë kemi edhe degradimin tej mase të mjedisit në Regjionin e Prizrenit.²⁰

¹⁶ Po aty neni 93

¹⁷ Kuvendi i Komunës së Suharekës, Malishevës dhe Mamushës

¹⁸ Te gjitha komunat veprojnë vetëm me një Inspektor të Mjedisit

¹⁹ Intervistë me z. Ilirian Bytyqin, Drejtorë për Administratë dhe Inspekcione -Suharekë

²⁰ Intervistë me z. Ramadan Tafallari- Zyrtar për mbrojtjen e mjedisit - Prizren

INFRASTRUKTURA LIGJORE NË MBROJTJEN E UJËRAVE NË KOSOVË

Autoritetet kompetente për administrimin e ujërave në Kosovë janë: Qeveria; Këshilli i Kosovës për Ujërat; Ministria; Autoritetet e Rajonit të Pellgut Lumor; dhe Komunitat.²¹

Me qëllim të mbrojtjes afatgjatë dhe shfrytëzimit të qëndrueshëm të resurseve ujore, administrimi i ujërave bazohet në parimin e minimizimit të përdorimit të resurseve: që do të thotë se, me rastin e aktiviteteve të cilat mund të kenë ndikim në ujëra, çdokush ka detyrim të sillet me kujdes dhe racionalisht t’i shfrytëzoj ujërat, të pengojë ndotjen e ujërave dhe të shmangë çfarëdo efekti negativ dhe rrezik për shëndetin publik dhe mjedisin. ndotësi paguan: që do të thotë se çdo person që shkakton apo lejon shkarkime të ndotjes do të përgjigjet financiarisht dhe penalisht për të gjitha shpenzimet që dalin, përfshirë edhe shpenzimet për parandalimin e ndotjes, masat kontrolluese të nevojshme, shpenzimet administrative, shpenzimet riparuese apo kompensuese, në pajtim me këtë ligj²².



Foto 4. Eksploatimi i zhavorrit në shtratin e drinit

Ujërat administrohen në nivel të tërësive hidrografike, të ndara me ujëndarëse në pellgje lumore duke marrë parasysh lidhshmërinë mes ujërave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë, në mënyrë të tillë që kufijtë administrativo-territorial të njësisë të administrimit lokal nuk mund të jenë pengesë, për administrimin e integruar të pellgut lumor. Territorin e Kosovës e përbëjnë katër pellgje të lumenjve: Drini i Bardh, i cili përfshin pellgjet e lumenjve

Bistrica e Pejës, Istog, Mirushë, Bistrica e Deçanit (Lumbardhi), Erenik, Toplluhë, Bistrica e Prizrenit (Lumbardhi) dhe Lumi i Plavës (Lumës); Ibri, i cili përfshin pellgjet e lumenjve Sitnicë, Llap dhe Drenicë; Morava e Binçit, e cila përfshin pellgun e lumit Krivarekë; dhe Lepenci, i cili përfshin pellgun e lumit Nerodima.²³

Ligji për Ujërat e Kosovës ka paraparë edhe themelimin e Këshillit të Kosovës për Ujërat si organ i pavarur. Këshilli është trup këshillëdhënës, që shqyrton çështjet sistemore të administrimit me ujëra, harmonizimin e nevojave dhe interesave të ndryshme, si dhe propozon masat për zhvillimin, shfrytëzimin dhe mbrojtjen e resurseve dhe sistemit ujor të Kosovës²⁴

Mbrojtja kundër efekteve të dëmshme të ujërave përfshin: a. mbrojtjen nga përmbytjet; dhe b. mbrojtjen nga erozioni sipërfaqësor.²⁵

Me qëllim të mbajtjes në gjendje të rregullt të shtretërve dhe brigjeve, të ujërrjedhave,

²¹ Neni 16 i Ligjit për Ujërat e Kosovës, http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2004_24_al.pdf

²² Neni 5 pika (d) dhe (f) i ligjit për ujërat e Kosovës, http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2004_24_al.pdf

²³ Po aty neni 6

²⁴ Po aty neni 17

²⁵ Po aty neni 37.2



Foto 5 Ndërrimi i drejtimit të rrjedhës së ujit në lumin Drini i Bardhë si pasojë e eksploatesve të zhavorrit

liqeneve, shtretërve, të kanaleve periferike kulluese, shtretërve dhe brigjeve të akumulimeve artificiale, si dhe të digave të tyre, është e ndaluar: a. ndërrimi i drejtimit të ujit në lumenj dhe kanal apo të krijimi i pengsave pa të drejtën ujore; b. nxjerrja, depozitimi I dheut, hedhja e mbeturinave, materialeve të tjera të ngurta dhe të lëngëta në ujë-rrjedha, liqene, akumulime dhe në brigjet e tyre; c. ndërtimi i objekteve të tjera, të cilat nuk shërbejnë për mbrojtjen nga përmbytjet, në largësi së paku 10 metra nga vija e plotave të larta të ujë-rrjedhave dhe akumulimeve; d. kryerja e punimeve, të cilat

mund të dëmtojnë shtratin dhe brigjet e ujë-rrjedhave, liqeneve, shtratin e kanaleve, tuneleve, akumulimeve ose pengimi i rrjedhës së lire të ujërave; e. kryerja e punëve në afërsi të ujë-rrjedhave, liqeneve, akumulimeve, tuneleve, të cilat do të mund të rrezikojnë stabilitetin e objekteve mbrojtëse ose përdorimin e tyre.²⁶

Leja Ujore lëshohet për: nxjerrje të ujit, shkarkim të ujërave të ndotura, ndërtimin, rindërtimin ose demelimin e objekteve që ndikojnë në regjimin ujor; aktivitetet e minierave dhe punimet gjeologjike, të cilat ndikojnë në regjimin e ujërave. shfrytësimin e rërës, zhavorrit, gurit dhe argjilit, dhe aktivitetet e tjera që mund të ndikojnë në regjimin ujor.²⁷

Lejet Ujore lëshohen nga Ministria dhe me akt nënligjor Ministria mund të delegojë veprimtaritë, për të cilat Autoriteti i Rajonit të Pellgut Lumor mund të lëshojë Leje Ujore. Leja Ujore rishqyrtohet së paku në çdo pesë (5) vjet.²⁸

Bartësi i të drejtës ujore detyrohet t'a informojë lëshuesin e lejes, në rast të ndryshimit në veprim, teknologji dhe shfrytëzim të ujit apo rastet e tjera që mund të kenë ndikim të rëndësishëm në regjimin ujor. Përdorimi i ujërave nëntokësore me qëllim të shfrytëzimit të energjisë gjeotermale do të konsiderohet si shfrytëzim i ujit që kërkon leje ujore sipas dispozitave të këtij.²⁹

Bartësi i lejes për shfrytëzimin, shkarkimin e ujërave të ndotura dhe për hedhjen e mbeturinave e substancave është i detyruar të bëjë matjet e sasisë së ujit të shfrytëzuar, ujërave të shkarkuara si dhe matjet e substancave të hedhura sipas mënyrës dhe kushteve të caktuara me leje. Bartësi i lejes ujore është i detyruar të instalojë dhe të mirëmbajë pajisjet për matje të sasisë së ujit të përdorur dhe shkarkimin e ujërave të ndotura. Bartësi i lejes ujore do t'u lejojë në çdo kohë qasje personave të autorizuar të autoritetit që e ka lëshuar atë.³⁰

²⁶ Po aty neni 39

²⁷ Po aty neni 56

²⁸ Po aty neni 56 paragrafi 5,6 dhe 7

²⁹ Po aty neni 56 paragrafi 8 dhe 9

³⁰ Po aty neni 57

Financimi për administrimin dhe zhvillimin e ujërave sigurohet nga: pagesa për shfrytëzimin e ujërave; pagesa për shkarkimin e ujërave; pagesa për nxjerrjen e materialeve inerte; buxheti i Kosovës; komunat; donacionet dhe grantet; dhe burimet e tjera financiare në pajtim me ligjin.³¹

KOMPETENCAT E KOMUNAVE NË ADMINISTRIMIN E UJËRAVE



Foto 6. Papastërtia dhe mbeturinat në Lubardhin e Prizrenit

Sipas Ligjit për Ujëra, detyrat dhe përgjegjësitë e komunave në administrimin e ujërave janë: të administrojnë me burimet për furnizimin me ujë, me rëndësi të nivelit lokal si dhe me burimet natyrore, krojet publike, pusët publike dhe vijat ujore.

Ndërsa, sipas Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale në Kosovë, komunat janë kompetente për ofrimin e shërbimeve publike të furnizimit me ujë. Kjo kompetence e tyre në rastin e shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit duhet të realizohet përmes Marrëveshjeve të Shërbimit

që nënshkruajnë komunat me kompanitë përkatëse regionale që ofrojnë shërbimet e veta në komunën përkatëse.

Në Rajonin e Pellgut të Drinit të Bardhë janë regjistruar 154 ndotës prej të cilëve 99 janë ndotës kolektiv dhe 56 janë ndotës individual. Lumenjtë, më të ngarkuar për nga numri i pikave shkarkuese ndotëse janë: Lumi i Istogut me 12, Lumbardhi i Prizrenit me 11, Drini i Bardhë me 9, Lumbardhi i Pejës me 7, Toplluha me 7, Klina me 5 ndotës, ndërsa për nga sasia prin Lumbardhi i Prizrenit. Megjithatë të gjitha këto bashkohen në Drinin e Bardhë dhe vazhdojnë në drejtim të Detit Adriatik³²

Në Regjionin e Prizrenit ekipi i projektit, i mbështetur nga zyrtar të MMPH-së dhe ata komunal ka evidentuar 78 ndotës prej të cilëve 56 ndotës kolektiv dhe 22 ndotës individual.³³

Në qendrën më turistike të Prevallës, nuk ka kanalizim të rregulluar dhe 4 gropat septike pavarësisht numrit prej 150 banorëve rezident janë shumë më të ngarkuara me numër transit të njerëzve.³⁴

Problematika me ujërat e zeza qëndron në gjithë komunat e Regjionit të Prizrenit. Mungesa e planeve për veprimet konkrete mbi administrimin e ujërave dhe ujërave të zeza ka bërë që në gjithë komunat të mos ketë kolektorë për trajtimin e tyre dhe si pasojë të gjithë ujërat e zeza derdhen në rrjedhat e lumenjve të cilët në masë shumë të madhe ndotin ujërat.

³¹ Po aty neni 65

³² Kadastr i ndotësve të ujërave të Kosaovës,
http://www.ammk-rks.net/repository/docs/Kadastr_i_ndotesve__te_ujerave_Shq.pdf

³³ Po aty faqe 18 , http://www.ammk-rks.net/repository/docs/Kadastr_i_ndotesve__te_ujerave_Shq.pdf

³⁴ Po aty faqe 19, http://www.ammk-rks.net/repository/docs/Kadastr_i_ndotesve__te_ujerave_Shq.pdf

Komuna e Prizrenit zgjidhjen e çështjes së problemit me ujëra të zeza e parasheh me projektin madhorë për rregullimin e shtratit të Lumëbardhit së bashku me sistemin e kanalizimit prej Gornje Selos e deri në Vlashnje e Tupec. Çka nënkupton që në fazën e parë të rregullohet sistemi i kanalizimit të fshatrave të grykës së Lumbardhit dhe sipas këtij projekti planifikohen të ndërtohen disa kolektorë të vegjël që trajtojnë ujërat e zeza. Për qytet parashihet ndërtimi i arteries të ujërave të zeza në të dy anët e Lumëbardhit. Mirëpo zyrtarët e qeverisë lokale nuk kanë informacion se kur do të jete i përfunduar ky projekt meqë janë arsyetuar së ky projekt është i Ministrisë.

KOMPETENCAT LIGJORE TË KOMUNAVE MBI ADMINISTRIMIN E MBETURINAVE DHE PROBLEMATIKA NË TEREN

Në bazë të ligjit për mbeturina, Komunat janë të detyruar të ndërmarrin hapat konkret me qëllim të hartimit të planeve për administrimin e mbeturinave.

Planet hartohen nga autoritetet lokale, konform Planit Strategjik të Kosovës për administrimin e mbeturinave. Sipas nevojës, Ministria, mund të kërkojë që dy ose më shumë komuna të hartojnë planin e përbashkët lokal për administrimin e mbeturinave në përputhje me Planin Strategjik. Planet dhe të hartohen së paku për periudhën prej 5 vitesh dhe rishqyrtohen sipas nevojës. Komunat hartojnë planin lokal të administrimit të mbeturinave brenda një viti, nga data e aprovimit të Planit Strategjik.

Hartimi i planit bëhet në bashkëpunim me përfaqësuesit e ofruesve të shërbimeve, të administrimit të mbeturinave, shoqatave të ndryshme ekonomike dhe përfaqësuesve nga organizatat joqeveritare si dhe institucionet profesionale³⁵

Komunat e Regjionit të Prizrenit deri më tani nuk kanë bërë Planin Lokal për administrimin e mbeturinave. Sipas zyrtarëve komunal; një arsye i tillë ka ardhur nga mos hartimi i Plani Strategjik i Kosovës për administrimin e mbeturinave³⁶. Sipas Ligjit për Mbeturina; Ministria në bashkëpunim me ministrinë dhe autoritetet tjera kompetente harton Planin Strategjik të Kosovës për Administrimin e Mbeturinave dhe miratohet nga Qeveria e Kosovës për periudhën dhjetë vjeçare.



Foto 7 .Deponi e egër-Prizren

Në bazë të ligjit për mbeturina si autoritete kompetente për administrimin e mbeturinave janë: Ministria dhe Komunat³⁷. Komunat kanë për detyrë: të hartojnë planin lokal për administrimin e mbeturinave; të hartojnë raporte vjetore mbi administrimin e mbeturinave të cilat i dorëzojnë në Ministri, në tremujorin e parë të vitit vijues; të rregullojnë, zbatojnë dhe organizojnë administrimin e mbeturinave komunale në territorin e tyre; të marrin pjesë në lëshimin e vendimeve për ndërtimin e objekteve, për trajtimin e mbeturinave; të kryejnë punë tjera, të

³⁵ Neni 10 i Ligjit për Mbeturina, http://assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2005_02-L30_al.pdf

³⁶ Intervistë me z.Ramadan Tafallari- Zyrtar për mbrojtjen e mjedisit-Prizren

³⁷ Po aty neni 13

përshkruara me këtë ligj si dhe aktet tjera, për administrim të mbeturinave; të caktojnë tarifafat për shërbimet e grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave komunale nga ndërmarrjet për administrimin e mbeturinave.³⁸

Dy apo më shumë komuna, për interesin e tyre, mund të bëjnë marrëveshje për administrimin e mbeturinave në territorin e tyre. Përmes inspektorit komunal mjedisor, bëjnë mbikëqyrjen dhe kontrollin për administrimin e mbeturinave.³⁹

Komunës i besohen punët e mbikëqyrjes inspektuese mbi veprimtaritë për administrimin e mbeturinave në ato objekte dhe pajisje, për të cilat lejen e ndërtimit e lëshon organi komunal, përveç mbikëqyrjes inspektuese në administrimin e mbeturinave të rrezikshme.⁴⁰

Po ashtu ky ligj ka rregulluar edhe mënyrën e financimit për administrimin e mbeturinave. Si burime kryesore për financim në bazë të këtij ligji janë: mjetet financiare nga buxheti i Kosovës; mjetet financiare nga buxheti komunal; donacionet dhe grantet; burimet nga pagesat e operatorëve, prodhuesve, zotëruesve dhe personave tjerë, sipas dispozitave të këtij ligji; burimet tjera financiare të përcaktuara me ligj. Për administrimin e mbeturinave mund të përdoren edhe instrumentet ekonomike.⁴¹

Komunat janë të detyruara të organizojnë grumbullimin e mbeturinave komunale të cilat nuk mund të hidhen në kontejner (mbeturinat e vëllimshme). Komunat rregullojnë organizimin dhe mënyrën e veçimit të mbeturinave për riciklim, në përputhje me planin lokal⁴².

Kuvendet e komunave të Regjionit të Prizrenit kanë dështuar edhe në aspektin grumbullimit të mbeturinave komunale që nuk mund të hidhen në kontejner. Në shumicën e rasteve në kontejner vërehet prani e mbeturinave të përziera të cilat në një masë të konsiderueshme bëhen si mbeturina të rrezikshme ngase nuk veçohen; dhe kjo bie në përgjegjësi të komunave ngase komunat janë autoriteti kryesorë për krijimin e kushteve për ndarjen e mbeturinave.

Komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive, për sa i përket interesit lokal, duke i respektuar standardet e përcaktuar në legjislacionin e zbatueshëm,: mbrojtjen e mjedisit lokal dhe ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, përfshirë furnizimin me ujë, kanalizimin dhe drenazhin, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugëve lokale, transportit lokal dhe skemave të nxehjes lokale⁴³.

³⁸ Po aty neni 15

³⁹ Po aty neni 15

⁴⁰ Po aty neni 44

⁴¹ Po aty neni 38

⁴² Po aty neni 28 paragrafi 4 dhe 6

⁴³ Neni 17 i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale,
http://assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L040_al.pdf

Përkundër asaj që Ligji për Vetëqeverisje Lokale lë në kompetencë të komunave në anën tjetër Ligji për Mbeturina si autoritet kryesorë për licencimin e ndërmarrjeve publike ka paraparë Zyrën e Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina. Në kuadër të autorizimeve dhe përgjegjësisë së Zyrës së Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina (ZRRUM) përfshihen:

- Licencimi i ndërmarrjeve publike që ofrojnë shërbimet e: ujësjellësit dhe kanalizimit, të ujërave të zeza; furnizimin e ujit me shumicë për ndërmarrjet e ujësjellësit; grumbullimit dhe transportimit të mbeturinave, dhe deponimit të mbeturinave (të gjithë bashkë "Ofruesit e Shërbimeve");
- Përcaktimi i tarifave të shërbimit për ofruesit e shërbimeve të licencuar nga ZRRUM, duke u përkujdesur që tarifat të jenë të drejta dhe të arsyeshme dhe të mundësojnë qëndrueshmërinë financiare të Ofruesve të Shërbimeve;
- Mbikëqyrja e zbatimit të standardeve të shërbimit që ofrojnë Ofruesit e licencuar të Shërbimeve;
- Aprovimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të Kartës së Konsumatorëve që rregullon të drejtat dhe obligimet e ndërsjella ndërmjet konsumatorëve dhe Ofruesve të Shërbimeve të licencuar nga ZRRUM;
- Mbikëqyrja e zbatimit të shkyçjeve të konsumatorëve dhe rregullimit të kyçjeve ilegale në sistemin e ujësjellësit dhe kanalizimit;
- Themelimi dhe mbështetja e Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve në shtatë regionet e Kosovës⁴⁴.

Siç është theksuar nga autoritetet e Komunave të rajonit të Prizrenit, aktualisht shumica nga e shërbimeve publike në komuna menaxhohen nga kompanitë rajonale, të cilat nuk i përgjigjen komunave, prandaj gjendja në këtë drejtim është e pakënaqshme, sidomos sa i përket ujërave dhe mbeturinave.

Mirëpo; kuvendet e komunave të Regjionit të Prizrenit kanë kontraktuar firma të ndryshme për grumbullimin e mbeturinave dhe mirëmbajtjen e ambientit të qytetit⁴⁵. Duke e ditur se autoriteti kryesorë për dhënie licencave për operatorët është vetëm ZRRUM atëherë mundë të konkludojmë se këto kompani në një farë mënyre operojnë edhe ilegalisht. Në anën tjetër zyrtarët komunal janë shpreh të kënaqshëm në ofrimin e shërbimeve nga këta operatorë andaj edhe duhet të krijohet mundësia ligjore që komunat të kenë edhe autoritet në licencimin e operatorëve për mbeturina.



Foto 8. Deponi e egër e mbeturinave të ngurta-Rahovec

Ajo çka vërehet në teren dhe që ka trendë gjithnjë në rritje janë edhe mbeturinat nga rrënimet dhe ndërtimet e objekteve ndërtimore. Hedhja e tyre në sipërfaqe të tokave të punëshme, hedhja e tyre pranë kontejnerëve,

Ajo çka vërehet në teren dhe që ka trendë gjithnjë në rritje janë edhe mbeturinat nga rrënimet dhe ndërtimet e objekteve ndërtimore. Hedhja e tyre në sipërfaqe të tokave të punëshme, hedhja e tyre pranë kontejnerëve,

⁴⁴ Ueb faqja e Zyrës së Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina, <http://www.wwro-ks.org/>

⁴⁵ Komuna e Prizrenit dhe Suharekës kanë kontraktuar një kompani për grumbullimin e mbeturinave

në hapësira banimi, në brigjet e lumenjve edhe më shumë e rëndon gjendjen e ambientit duke ndikuar në ekosistem, aq më tepër kur këto mbeturina hidhen si mbeturina të përziera duke bërë që të jenë shumë të rrezikshme për mjedisin.

Kuvendi komunal i Prizrenit ka marrë vendim për licencimin e një deponie për mbeturinat e ngurta mirëpo kjo iniciativë nuk është ndërmarrë nga 5 kuvendet tjera komunale të cilat edhe ashtu kanë probleme sa i përket menaxhimit të mbeturinave të ngurta.

Edhe pse kuvendi komunal i Prizrenit ka një operator për deponimin e mbeturinave të ngurta; gjendja në teren aspak nuk qëndron e mirë. Për më shumë; në shumë lokalitete të komunave të Regjionit të Prizrenit mundë të gjenden mbeturinat të cilat hidhen nga personat e papërgjegjshëm mirëpo edhe nga ana e qeverive lokale nuk ndërmerren iniciativa për largimin e tyre.

Po ashtu mundë të konkludohet se inspektoratet komunale janë treguar tejte neglizhent në monitorimin e ligjeve duke mos arritur përmbushjen e objektivave në parandalimin dhe kontrollimin e mbeturinave të ngurta.

LEGJISLACIONI PËR MBROJTJEN E TOKËS BUJQËSORE DHE NDIKIMI NË MJEDIS

Me masat për zbatimin e politikës bujqësore dhe të zhvillimit të zonave rurale, synohet të arrihen objektivat e përgjithshme konkretisht mbrojtja e qëndrueshme e mjedisit⁴⁶.

Pronari apo shfrytëzuesi i tokës bujqësore është i detyruar që tokën bujqësore t’a shfrytëzoj në mënyrën e cila i përshtatet vetive natyrore të tokës, duke mos e zvogëluar vlerën e saj dhe duke përdorur masat agroteknike përkatëse. Nëse pronari apo shfrytëzuesi i tokës bujqësore nuk e shfrytëzon tokën sipas paragrafit 1 të këtij neni do të bëjë

përpjekje të siguroj shfrytëzimin e saj përmes dhënies së tokës më qira apo në mënyrë tjetër në pajtim me dispozitat e dhënies së paluajtshmërive në shfrytëzim⁴⁷.



Foto 9. Shkatërrimi i tokës bujqësore nga eksploatuesit e zhavorrit

Më qëllim të mbrojtjes së potencialit bujqësor dhe shfrytëzimit racional të tokës bujqësore Ministria do të caktoj kriteret e klasifikimit të tokave bujqësore sipas bonitetit dhe do të mbajë hartat e klasifikimit. Çdo ndërrim i destinimi sipas paragrafit 3 të këtij neni, mund të bëhet vetëm sipas ligjit dhe me vendim të organit kompetent komunal, pasi të jetë marrur pëlqimi nga Ministria në projektin e rregullimit

⁴⁶ Neni 4 i Ligjit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, http://assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2009_03-L-98_al.pdf

⁴⁷ Neni 4 i Ligjit për Tokën Bujqësore, http://assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2005_02-L26_al.pdf

hapësinor. Përfundimisht kur nuk ekziston ndonjë mundësi tjetër dhe kur këtë e kërkon interesi i përgjithshëm toka bujqësore, përkatësisht toka pyjore e klasit 1 - 4 me plan hapësinor, përkatësisht me plan zhvillimor komunal, mund të përcaktohet si tokë për destinime tjera⁴⁸.



Foto 10 .Shkatërrimi i tokës bujqësore nga eksploatuesit e zhavorrit

Organi kompetent komunal përkatësisht organi tjetër kompetent për dhënien e lejes për ndërtim të objektit apo për kryerjen e punëve ose për dhënien e lejes për eksploatim të lëndëve industriale dhe mineraleve të mihjeve sipërfaqësore dhe nëntokësore, deponimin e mbeturinave, hirit, mbetjet e përpunimit të drurit dhe të ngjashme mund të jap leje nëse investitori apo shfrytëzuesi përveç dokumentacionit tjetër të nevojshëm paraqet edhe dëshmi për pagesën e kompensimit për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore⁴⁹.

Inspektori është i autorizuar dhe ka për detyrë të inspektoj: shfrytëzimin e tokës bujqësore për qëllime jobujqësore dhe të urdhëroj ndalimin nëse ky ndërrim bëhet në kundërshtim me dispozitat e ligjit. Nëse konstatohet se janë shkelur dispozitat e këtij ligji apo dispozitat e nxjerrura në bazë të tij, inspektori me shkrim do t'i konstatoj parregullsitë dhe mangësitë dhe me vendim do ti caktoj masat dhe afatin për evitimin e tyre. Nëse pala nuk e respekton vendimin apo nuk vepron sipas vendimit të inspektorit do të njoftohen organet kompetente dhe do të iniciohet procedura në gjykatën kompetente⁵⁰.

KUNDËRVAJTJET

Me dënim me gjobë prej 1.000 € deri në 10.000 € do të dënohet për kundërvajtje personi fizik, përkatësisht personi juridik nëse: e ndërron destinimin e tokës bujqësore apo e shfrytëzon për qëllime jo bujqësore para së të nxirret plani i rregullimit hapësinor më të cilin kësaj toke i përcaktohet destinimi (neni 11.1 i këtij Ligji); shfrytëzon tokën⁵¹.

Përveç dënimit për kundërvajtje sipas nenit 42 të këtij Ligji, kryesit mund t'i shqiptohet masa mbrojtëse konfiskimi i lëndës - sendit i cili është përdorë apo është i destinuar për kryerjen e kundërvajtjes, apo ka mbetur si rezultat i kryerjes së kundërvajtjes si dhe masa mbrojtëse për konfiskimin e pasurisë e cila është arritur si rezultat i kundërvajtjes⁵².

Deri në nxjerrjen e planit hapësinor shfrytëzimi i tokës bujqësore për qëllime jobujqësore mund të bëhet vetëm në bazë të vendimit të kuvendit komunal⁵³.

⁴⁸ Po aty neni 11

⁴⁹ Po aty neni 19

⁵⁰ Po aty neni 39

⁵¹ Po aty neni 42

⁵² Po aty neni 43

⁵³ Po aty neni 44

Duke ditur që asnjë nga Komunitat e Regjionit të Prizrenit nuk e kanë të hartuar Planin Zhvillimor Komunal, atëherë mund të vijmë në përfundim se çdo ndërrim i deri tanishëm i tokës bujqësore për destinime të tjera është në kundërshtim të plotë me ligjin për tokën bujqësore.

KONKLUZIONE

Shikuar nga ky prizëm, Kosova ka një mori organesh që janë të autorizuar të ndërmarin veprime konkrete në mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit në Kosovë. Edhe përkundër ekzistimit të këtyre organeve që ngërthehen në MMPH, ruajtja e mjedisit paraqitet si sfidë shumë duke analizuar gjendjen aktuale që mbretëron në Komunitat e Regjionit të Prizrenit.

Sa i përket legjislacionit, Kuvendi i Kosovës ka miratuar një pako ligjesh në drejtim të mbrojtjes së mjedisit, mirëpo vërehet një mos zbatueshmëri në masë të madhe nga organet ekzekutive qofte të nivelit qendror apo edhe atë lokal. Sfidat e tilla duhet të tejkalohen andaj edhe duhet të fillohet në implementimin e ligjeve nga organet kompetente.

Decentralizimi i kompetencave nga niveli qendror në nivel lokal është në proces të ngadalshëm. Me qëllim të mos krijimit të obstrukcioneve në drejtim të mbrojtjes së mjedisit, organet qendrore duhet të fillojnë të bartin kompetencat në nivel lokal dhe duhet të harmonizohet legjislacioni ekzistues në drejtim të zbritjes së kompetencave në nivel vertikal e jo horizontal siç është praktikuar deri më tani.

Edhe qeveritë lokale janë treguar të pa aftë sa i përket mbrojtjes së mjedisit. Shumica e komunave nuk kanë legjislacionin sekondar përkatësisht Rregulloret komunale për mbrojtjen e mjedisit. Po ashtu sipas parimit “ndotësi paguan” komunitat janë të pafuqishme si pasojë e mungesës së kapaciteteve inspektoriale.

Roli i organeve të drejtësisë në drejtim të mbrojtjes së mjedisit është i pashmangshëm. Edhe me kodin penal të Republikës së Kosovës parashihen ndëshkimet mbi personat fizik dhe juridik që shkaktojnë ndotjen e mjedisit. Policia dhe Prokuroria duhet të jenë më efektive sa i përket iniciativave për mbrojtjen e mjedisit në përgjithësi.

Mbrojtja e ambientit duke krijuar zona të mbrojtura dhe menaxhimi i tanishëm i parqeve nacionale është shumë e dobët dhe nuk behet në formë aktive. Nevojitet një ndihmë teknike dhe fonde me qëllim të bërjes së këtyre zonave funksionale sa i përket konservimit, arsimimit dhe rekreimit. Duhet të ndërmerren po ashtu edhe hapa për mbrojtjen e ekosistemeve dhe specieve që ndodhen jashtë këtyre zonave duke mbrojtur llojet e rralla të bimëve dhe mbrojtjes së lumenjve nga ndotja dhe ekstradimi i rërës.

REKOMANDIMET:

- Komunat të ndërmarrin veprime konkrete në drejtim të hartimit të planeve lokale për mbrojtjen e mjedisit
- Komunat të hartojnë planet për administrimin e mbeturinave.
- Te ngitet bashkëpunimi ndërmjet inspektorateve në nivele qendror dhe lokal për mbrojtje të mjedisit
- Ministria gjegjëse duhet të filloj në hartimin e Planit Strategjik të Kosovës për administrimin e mbeturinave
- Të vihet një kontroll strikt mbi eksploatuesit e zhavorrit dhe gurorëve
- Të harmonizohen ligjet me qëllim të mos krijimit të kompetencave në nivele të ndryshme
- Komunat të fillojnë me draftimin e rregulloreve për mbrojtjen e mjedisit
- Të implementohen ligjet që rregullojnë mbrojtjen e mjedisit në përgjithësi
- Prokuroria dhe policia të jetë më efikase në drejtim të trajtimit të lëndëve që kanë të bëjnë më mbrojtjen e mjedisit
- Të ngiten buxhete komunale në drejtim të mbrojtjes së ambientit
- Të krijohet mundësia ligjore që komunat të kenë edhe autoritet në licencimin e operatorëve për grumbullimin e mbeturinave.
- Komunat apo OJQ-të duhet të ndërmarrin fushata për senzibilizimin e qytetarëve për mbrojtjen e mjedisit

LISTA E BURIMEVE TË SHFRYTËZUARA

22

Dokumentet zyrtare

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Kuvendi i Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2008 http://assemblykosova.org/common/docs/Kushtetuta_sh.pdf

Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit, Kuvendi i Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2009, http://assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2009_03-L-025_al.pdf

Ligjit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, Kuvendi i Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2009 http://assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2009_03-L-98_al.pdf

Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Kuvendi i Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2008 http://assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L040_al.pdf

Vendim nr 55/2005 , Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë, Prishtinë 2005 <http://www.mmph-ks.org>

Ligji për Ujërat e Kosovës, Kuvendi i Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2004 http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2004_24_al.pdf

Ligji për Miniera dhe Minerale, Kuvendi i Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2010 <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2010-163-alb.pdf>

Ligji për Inspektionin Bujqësor, Kuvendi i Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2008 http://assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L-029_al.pdf

Kodi Penal i Kosovës, Kuvendi i Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2008 http://www.md-ks.org/repository/docs/Kodi_i_Perkohshem_Penal_i_Kosoves_RA_2003-25.pdf

Plani i Veprimit për Partneritet European 2010, http://www.mei-ks.net/repository/docs/PVPE_2010_Final_-_SQ.pdf

